



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
KOMISIONI I ANKIMIT

Nr. 771/4 prot.

Tiranë, më 01.06.2026

VENDIM

Nr. 14 datë 01/06/2026

“Për pranimin e ankimit të organizatës jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social” ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 09, datë 14.05.2026, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”

Komisioni i Ankimit i përbërë prej:

Z. Erjon Ndreca - Kryetar
Znj. Sindi Prifti - Anëtar
Znj. Arsilda Mamica - Anëtar

asistuar nga Sekretariati Teknik, sot, me datë 01.06.2026, mori në shqyrtim ankimin administrativ, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të organizatës “Qendra Shqiptare për Impakt Social”, depozituar pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me datë 20.05.2026, Nr. 771/7 Prot, me të dhënat e mëposhtme:

ANKUES: “Qendra Shqiptare për Impakt Social”, përfaqësuar nga znj. Fernada Cenko, Drejtore Ekzekutive.

OBJEKTI: Ankimi ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 09, datë 14.05.2026, administruar nga DNJF, me Nr. 771/6 Prot, datë 22.05.2026, “Për kërkesën për përfitim financimi të Organizatës Jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social”.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; (e ndryshuar).

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”, (e ndryshuar me Urdhrin nr. 124 datë 10.02.2026)

Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit që ndër të tjera kërkon *“rishikimin e procedurës dhe pranimin e kërkesës duke e konsideruar si të padrejtë përjashtimin pasi, pretendon se është paraqitur dokumentacion provues për kritere të veçanta duke u bazuar në metodologjinë përkatëse dhe jo në nxjerrjen e vlerësimeve diskrecionale apo konkluzioneve penalizuese mbi performancën institucionale të subjektit aplikues.*

VËREN SE:

Referuar dokumentacionit të përcjellë në aplikimin e Organizatës Jofitimprurëse *“Qendra Shqiptare për Impakt Social”*, rezulton se Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, me Vendimin Nr. 09, datë 14.05.2026, **vendosi unanimitisht refuzimin e aplikimit për financim.**

Pranë Komisionit të Ankimit në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas me datë 20.05.2026, Nr. 771/6 Prot., është administruar ankimi i *“Qendra Shqiptare për Impakt Social”*, përfaqësuar nga znj. Fernada Cenko, Drejtore Ekzekutive.

Kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 09, datë 14.05.2026, në ankimin e saj me shkrim znj. Cenko, përfaqësuese e *“Qendra Shqiptare për Impakt Social”*, ka parashtruar se:

- Përjashtimi konsiderohet i padrejtë pasi është paraqitur dokumentacion provues për kriteret e veçanta duke u bazuar në metodologjinë përkatëse si dhe vlerësimi nuk është objektiv në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga organizata.

Në vijim të këtyre pretendimeve, ankuesi ka kërkuar *“Pranimin e ankimit administrativ, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e depozituar”*.

Rrethanat faktike të çështjes

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse *“Qendra Shqiptare për Impakt Social”* protokolluar me Nr. 771 Prot., datë 13.03.2026, Organizata Jofitimprurëse ka aplikuar për financim nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

Bazuar në kriteret e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, e ndryshuar si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”*, e ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026, organizata ka përcjellë dokumentacionin i cili është marrë në shqyrtin nga Komisioni i Vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar ngritur me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 104, datë 19.02.2026, pasi mori në dorëzim dhe shqyrtoi dokumentacionin e përcjellë nga organizata, mbajti Relacionin nr. 755/1 prot., datë 01.04.2026 *“Mbi kërkesën për financim nga organizata jofitimprurëse e autorizuar “Qendra Shqiptare për Impakt Social”*. Në këtë relacion u evidentuan mangësitë në

dokumentacionin e përcjellë të cilat përbëjnë shkak skualifikimi dhe komisioni në mënyrë unanime vendosi njoftimin e organizatës jofitimprurëse se komisioni do të vijojë me procedurën e verifikimit të kriterëve, pas plotësimit të të metave, nëpërmjet dërgimit të dokumentacionit të poshtëshënuar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.

Me shkresën nr. 771/2 prot., datë 02.04.2026, me lajmërim marrje (RR813437499AA), të marrë nga Organizata jofitimprurëse “*Qendra Shqiptare për Impakt Social (QSHIS)*” në datën 07.04.2026, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit plotësues, si më poshtë:

1. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT);
2. Akti i autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, i lëshuar në vitin 2025 (autorizim pa afat);
3. Kopje të kontratave të grantit të lidhura me partnerë, në kuadër të zbatimit të projekteve të njëjta/ngjashme, për tre (3) vitet e fundit, në gjuhën shqipe;
4. Vërtetim i llogarisë bankare të organizatës;
5. Vërtetim nga gjykata që organizata nuk është në proces falimentimi (i përditësuar);
6. Pasqyra financiare e vitit të fundit, e nënshkruar nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe nga drejtuesi i organizatës, si dhe e konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Referuar procesverbalit të mbledhjes së datës 14.05.2025, Komisioni i Vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”, ka vijuar procesin e vlerësimit të kërkesës për aplikim me pjesëmarrjen e katër anëtarëve të tij.

Në vijim, me shkresën nr. 771/3 prot., datë 10.04.2026, organizata “*Qendra Shqiptare për Impakt Social (QSHIS)*” ka përcjellë dokumentacionin si më poshtë:

1. Certifikatë e regjistrimit (NIPT), nr. serial 41240111378, e njehsuar me origjinalin;
2. Autorizim i muajit prill 2025 nga Ministri i Drejtësisë, i njehsuar me origjinalin;
3. Kopje të kontratave të grantit të lidhura me partnerë, në kuadër të zbatimit të projekteve të njëjta/ngjashme për tre (3) vitet e fundit, në gjuhën shqipe, të njehsuara me origjinalin;
4. Vërtetim i llogarisë bankare të organizatës, në origjinal;
5. Vërtetim nga gjykata që organizata nuk është në proces falimentimi (i përditësuar), në origjinal;
6. Pasqyra financiare e vitit 2024, e nënshkruar nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe nga drejtuesi i organizatës, e konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se organizata ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar **brenda afatit ligjor prej 5 (pesë) ditësh nga marrja e njoftimit.**

Pas administrimit të dokumentacionit të plotë, në bazë të pikës 14/1 të VKM nr. 227, datë 23.04.2023, ku përcaktohet se:

“Komisioni Vlerësues vlerëson përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, bazuar në metodologjinë e miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, Komisioni vijoi me procedurën e vlerësimit (pikëzimit), sipas tabelës tip të miratuar në Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 07.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Bazuar në këtë vlerësim, organizata jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social (QSHIS)” u pikëzua sipas tabelës TIP, duke marrë në total 19 pikë nga 50 pikë të mundshme.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit ka dalë në përfundimin se:

Nga verifikimi administrativ rezultoi se organizata ka përcjellë dokumentacionin bazë që shmang skualifikimin e menjëhershëm, por janë konstatuar mungesa në një numër të konsiderueshëm dokumentesh, të cilat janë thelbësore për vlerësimin e aftësisë së organizatës për zbatimin e projektit në praktikë dhe me efektivitet, konkretisht:

1. Organizata nuk ka paraqitur vërtetime nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit, megjithëse ka përcjellë kontrata.
2. Organizata nuk ka paraqitur inventarin e pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe listëpagesat e punonjësve të 3 muajve të fundit duke bërë të pamundur vlerësimin e kapaciteteve organizative dhe logjistike për ofrimin e shërbimit.
3. Organizata nuk ka paraqitur asnjë letër referencë prej përfituesve të ndihmës juridike parësore, edhe pse ka raportuar një numër të konsiderueshëm rastesh pranë DNJF-së në financimin e saj të mëparshëm nga ky institucion.
4. Organizata ka paraqitur foto të ambienteve të brendshme, në të cilat nuk identifikohet që të ketë një ambient të veçuar për trajtimin e rasteve sensitive.

Komisioni i Vlerësimit, në mungesë të dokumentacionit të sipërcituar dhe me qëllim vlerësimin e kapaciteteve reale të organizatës për zbatimin në praktikë të projektit dhe për ofrimin me efektivitet të ndihmës juridike parësore, vendosi të kryejë një vlerësim më të gjerë të aplikimit të saj, duke analizuar edhe elementë të tjerë të rëndësishëm si korrektësia dhe plotësia e dokumentacionit të paraqitur, si dhe mënyra e zbatimit të projektit të financuar nga DNJF në vitin paraardhës.

Nga analiza e dokumentacionit dhe e zbatimit të projektit të mëparshëm për të cilin organizata ka përfituar financim nga DNJF në vitin paraardhës janë konstatuar gjithashtu pasaktësi të përsëritura në raportim, administrim dokumentacioni dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Gjithashtu, nga raportimet periodike mbi financimin e vitit paraardhës është konstatuar një mospërputhje ndërmjet numrit të rasteve për të cilat ka përfituar financim dhe atyre të realizuara në praktikë. Edhe formularin TIP të aplikimit për projektin e ri, organizata në fjalë deklaroi sërish një numër të përafërt rastesh sa në aplikimin e mëparshëm, duke mos u bazuar në realizimin faktik të vitit paraardhës, pavarësisht diferencës së evidentuar ndërmjet kapacitetit të deklaruar dhe realizimit faktik të projektit të mëparshëm. Kjo mospërputhshmëri cënon besueshmërinë e informacionit të paraqitur, si dhe ndikon drejtpërdrejt në procesin e pikëzimit dhe vlerësimit të projektit.

Mospërputhja e dokumentacionit të kërkuar në mënyrë të plotë dhe në formën e kërkuar nga ligji, nga një organizatë që ka përfituar më parë financim dhe është njohëse e procedurave të aplikimit, reflekton mungesë serioziteti dhe përgjegjshmërie nga ana e OJF-së në përmbushjen e kërkesave të thirrjes.

Të gjitha këto pasaktësi dhe mungesa në dokumentacionin e përcjellë krijojnë bindjen se organizata nuk disponon kapacitetet e nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi dhe nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në thirrje për sa i përket organizimit, dokumentimit dhe provueshmërisë së kushteve të zbatimit të projektit. Në këto kushte, nuk garantohet përmbushja e standardeve minimale të kërkuara për zbatimin efektiv të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Komisioni i Vlerësimit, duke marrë në konsideratë performancën e përgjithshme të organizatës, mangësitë e konstatuara në dokumentacion dhe parregullsitë e evidencuara gjatë zbatimit të

projekteve të mëparshme, ka vlerësuar se organizata jofitimprurëse dhe projekti i paraqitur nga ato **nuk plotëson kriteret e nevojshme për t'u kualifikuar për financim dhe, për rrjedhojë, kërkesa për financim refuzohet.**

Vlerësimi i Komisionit të Ankimit mbi procedurat e ndjekura në kuadër të aplikimit të “Qendra Shqiptare për Impakt Social”, për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit.

Në mbështetje të pikës 5 të VKM nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ndërmarrë masat për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore (*Afati i aplikimit 16.02.2026 - 16.03.2026*):

- Buletini nr. 4, viti 2026: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2026/4/0cdd63ac-bd59-4aec-ac66-232c3546e049;q=P%C3%ABr%20shpalljen%20e%20thirrjes%20p%C3%ABr%20financimin%20e%20OJF-ve%20t%C3%AB%20autorizuara%20p%C3%ABr%20ofrimin%20e%20Ndhm%C3%ABs%20Juridike%20Par%C3%ABsore,%20viti%202026%E2%80%9D>.

Gjithashtu, thirrja për financim është publikuar edhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në rubrikën njoftime, si vijon:

- link: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/newsroom/njoftime/>

Në këtë kuadër me qëllim trajtimin e aplikimeve të paraqitura në afatet e mësipërme, në zbatim të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019 e ndryshuar, me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 104 Prot., datë 11.02.2026, u ngrit Komisioni i Vlerësimit dhe i Ankimit.

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social”, protokolluar me Nr. 771 Prot., datë 13.03.2026, e cila rezultoi e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. Kjo kërkesë rezultoi e paraqitur brenda afatit të thirrjes (*Afati i aplikimit 16.02.2026 - 16.03.2026*).

Në vijim të trajtimit të këtij aplikimi, me Vendimin Nr. 9 datë 14.05.2026, Komisioni i Vlerësimit refuzoi aplikimin e organizatës jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social”.

Vendimi Nr. 9 datë 14.05.2026, iu komunikua organizatës nëpërmjet shërbimit postar. Sipas informacionit të marrë pranë shërbimit postar, organizatës i është komunikuar vendimi me datë 18.05.2026.

Me shkresën e protokolluar pranë Drejtorisë me Nr. 771/6 Prot., datë 22.05.2026 organizata ka ushtruar të drejtën e ankimit. **Ky ankim, është bërë brenda afatit pesë ditor të parashikuar në pikën 16 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019 e ndryshuar.**

Komisioni i Ankimit duke u bazuar në procedurat e mësipërme, mbi dokumentacionin e depozituar nga organizata, parashtrimet e paraqitura në ankim, dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit, konstaton se:

Bazuar në Pikën 2, të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit

të tyre”, e ndryshuar rezulton se procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar janë bërë duke u bazuar në parimet:

- a) konkurrueshmërisë;
- b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që paraqesin kërkesën për përfitimin e financimit;
- c) transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar;
- ç) kriterëve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuar në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;
- d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;
- dh) respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;
- e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfituesve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;
- ë) ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;
- f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në Pikën 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019 e ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Për t’u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë këtu edhe kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë”*.

Këto kërkesa specifike janë përcaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”*, (e ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026), të cilat lidhen me prioritetet e kërkuara dhe targetin për secilin prioritet.

Evidentohet se organizata në përputhje me Pikën 6 të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”* e ndryshuar, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, referuar të cilit, Komisioni i Vlerësimit në analizë përmbajtësore ka konkluduar se duke marrë në konsideratë performancën e përgjithshme të organizatës, mangësitë e konstatuara në dokumentacion dhe parregullsitë e evidencuara gjatë zbatimit të projekteve të mëparshme, rezulton se organizata jofitimprurëse dhe projekti i paraqitur nuk plotëson kriteret e nevojshme për t’u kualifikuar për financim dhe, për rrjedhojë, kërkesa për financim refuzohet.

Konkretisht, referuar Vendimit të Komisionit të Vlerësimit rezulton se bazuar në relacionin arsyetues Nr.771/4 Prot. Datë 14.05.2026, arsyet e skualifikimit të organizatës “Qendra Shqiptare për Impakt Social”, janë:

1. Organizata nuk ka paraqitur vërtetime nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit, megjithëse ka nënshkruar kontratë

2. Organizata nuk ka paraqitur inventarin e pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe listëpagesat e punonjësve të 3 muajve të fundit duke bërë të pamundur vlerësimin e kapaciteteve organizative dhe logjistike për ofrimin e shërbimit.
3. Organizata nuk ka paraqitur asnjë letër referencë prej përfituesve të ndihmës juridike parësore, edhe pse ka raportuar një numër të konsiderueshëm rastesh pranë DNJF-së në financimin e saj të mëparshëm nga ky institucion.
4. Organizata ka paraqitur foto të ambienteve të brendshme, në të cilat nuk identifikohet që të ketë një ambient të veçuar për trajtimin e rasteve sensitive.
5. Nga analiza e dokumentacionit dhe e zbatimit të projektit të mëparshëm për të cilin organizata ka përfituar financim nga DNJF në vitin paraardhës janë konstatuar gjithashtu pasaktësi të përsëritura në raportim, administrim dokumentacioni dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Nga raportimet periodike mbi financimin e vitit paraardhës është konstatuar një mospërputhje ndërmjet numrit të rasteve për të cilat ka përfituar financim dhe atyre të realizuara në praktikë. Edhe formularin TIP të aplikimit për projektin e ri, organizata në fjalë deklaroi sërish një numër të përafërt rastesh sa në aplikimin e mëparshëm, duke mos u bazuar në realizimin faktik të vitit paraardhës, pavarësisht diferencës së evidentuar ndërmjet kapacitetit të deklaruar dhe realizimit faktik të projektit të mëparshëm. Kjo mospërputhshmëri çënon besueshmërinë e informacionit të paraqitur, si dhe ndikon drejtpërdrejt në procesin e pikëzimit dhe vlerësimit të projektit.

Për sa më sipër, Komisioni i Ankimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosje, pretendimeve të ngritura në ankim dhe arsytimit të Komisionit të Vlerësimit, vlerëson se:

Lidhur me pikën 1, Komisioni i Ankimit vlerëson se ky arsyetim nuk qëndron, pasi referuar metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura konkretisht në pikën 3 të seksionit të kriterëve të veçanta mbi kapacitetin financiar të organizatës, specifikohet se paraqitja e vërtetimeve ose letrave referuese nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit përbën një element që merret në konsideratë në procesin e vlerësimit cilësor dhe pikëzimit të aplikimit. Mungesa e këtyre dokumenteve mund të ndikojë në nivelin e pikëve të përfituara nga aplikanti, **por nuk është parashikuar si kriter skualifikues dhe as si shkak për përjashtimin e organizatës nga procedura e vlerësimit.**

Lidhur me pikën 2, Komisioni i Ankimit vlerëson se mungesa e inventarit të pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe e listëpagesave të punonjësve për tre muajt e fundit, nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikim të aplikimit. Referuar metodologjisë së sipërcituar, konkretisht në pikën 2 të seksionit për kriteret e veçanta mbi aktivet afatgjata të organizatës si dhe në pikën 6 të seksionit të kriterëve të veçanta mbi kapacitetin financiar të organizatës, këto dokumente shërbejnë për të evidentuar kapacitetet organizative dhe logjistike të organizatës dhe **përbëjnë avantazh, por mosparaqitja e tyre nuk përbën shkak për përjashtimin nga konkurrimi.**

Lidhur me pikën 3, Komisioni i Ankimit vlerëson se mungesa e letrave të referencës nga përfituesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore **nuk përbën shkak ligjor ose procedural për skualifikimin e organizatës.** Ashtu si në rastin e referencave të partnerëve, paraqitja e këtyre dokumenteve synon të mbështesë vlerësimin e përvojës dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara nga organizata, duke përbërë një element avantazhues në procesin e pikëzimit, bazuar në pikën 2 të kriterëve të veçanta mbi performancën e organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga Ministri i Drejtësisë.

Lidhur me pikën 4, Komisioni i Ankimit vlerëson se qëndrimi i Komisionit të Vlerësimit është bazuar në konstatimin se nga fotografitë e paraqitura nuk identifikohet një ambient i veçuar për trajtimin e rasteve sensitive përbën një vlerësim vetëm të elementeve vizuale të dokumentacionit

dhe nuk mbështetet në prova objektive që të vërtetojnë mungesën e një ambienti të tillë. Referuar Urdhrit nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, ndër kriteret e vlerësimit të infrastrukturës parashikohet ekzistenca e një zyre të brendshme takimesh, të izoluar nga mjedisi përreth, për trajtimin e rasteve sensitive, si rastet e dhunës në familje, fëmijëve të abuzuar dhe raste të tjera që kërkojnë ruajtjen e konfidencialitetit.

Nga shqyrtimi i fotografive të paraqitura në kuadër të aplikimit, si dhe i dokumentacionit të bashkëlidhur ankimit, rezulton se organizata krijon bindjen se disponon një zyrë të veçuar dhe të izoluar nga ambientet përreth, e përshtatshme për zhvillimin e takimeve konfidenciale dhe trajtimin e rasteve sensitive. Për rrjedhojë, pretendimi se nuk identifikohet një ambient i tillë nuk gjen mbështetje në dokumentacionin e administruar.

Gjithashtu, Komisioni i Ankimit vlerëson se ky fakt konfirmohet edhe nga monitorimi i kryer nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, i pasqyruar në memo nr. 1068/3, datë 28.04.2025, “Raport vlerësimi i strukturës organizative për ndihmën juridike parësore të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, të financuara nga buxheti i shtetit”. Në këtë raport është konstatuar se: “Nga monitorimi i kryer në terren ka rezultuar se zyra e brendshme e punës në të cilën ushtronin veprimtarinë punonjësit e ndihmës juridike parësore është e izoluar nga mjedisi përreth duke mundësuar kështu krijimin e një ambienti të përshtatshëm për pritjen e klientëve, trajtimin e rasteve sensitive (dhunë në familje, fëmijë të abuzuar) dhe ruajtjen e konfidencialitetit në lidhje me çështjet e tyre”.

Në këto kushte, duke qenë se vetë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka verifikuar në terren ekzistencën dhe përshtatshmërinë e këtij ambienti, Komisioni i Ankimit çmon se arsyetimi i Komisionit të Vlerësimit nuk është i bazuar.

Lidhur me pikën 5, Komisioni i Ankimit vlerëson se arsyetimi i Komisionit të Vlerësimit nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar skualifikimin e organizatës.

Së pari, pretendimi se gjatë zbatimit të projektit të mëparshëm janë konstatuar pasaktësi në raportim, administrimin e dokumentacionit dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore nuk shoqërohet me referenca konkrete mbi natyrën e këtyre pasaktësive, masën në të cilën ato kanë ndikuar në realizimin e projektit, si dhe pasojat e tyre në marrëdhënien kontraktore ndërmjet palëve. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që ndaj organizatës të jenë marrë masa administrative, të jenë konstatuar shkelje të rënda kontraktore apo të jetë proceduar me ndërprerjen e financimit për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të saj.

Përkundrazi, rezulton se organizata ka vijuar zbatimin e projektit të financuar, ka raportuar periodikisht pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe ka përfunduar periudhën e financimit, çka tregon se mangësitë e evidentuara, nëse kanë ekzistuar, nuk kanë qenë të një natyre të tillë që të cenojnë në mënyrë thelbësore realizimin e projektit apo përmbushjen e objektivave të financimit. Kjo vërtetuar me raportin e monitorimit të përdorimit të fondeve nga organizata jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social”, protokolluar me Nr. 908/1 datë 07.05.2026. Së dyti, lidhur me mospërputhjen ndërmjet numrit të rasteve të planifikuara dhe atyre të realizuara në kuadër të financimit të mëparshëm, Komisioni i Ankimit vlerëson se ky element mund të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të realizueshmërisë së objektivave të projektit dhe në procesin e

pikëzimit të aplikimit, por nuk përbën në vetvete shkak për skualifikim. Numri i rasteve të parashikuara në formularin tip të aplikimit përfaqëson një projeksion të aktivitetit që organizata synon të realizojë gjatë periudhës së financimit dhe nuk mund të konsiderohet automatikisht si informacion i pasaktë vetëm për faktin se realizimi i një projekti të mëparshëm ka rezultuar më i ulët se planifikimi fillestar.

Për më tepër, metodologjia e financimit nuk parashikon si kriter skualifikues ekzistencën e diferencave ndërmjet objektivave të planifikuara dhe rezultateve të arritura në një financim të mëparshëm. Në rastin konkret, ky element mund të ndikojë në vlerësimin e kapaciteteve të organizatës dhe në pikëzimin e aplikimit, por jo të shërbejë si bazë për përjashtimin e saj nga procedura e financimit.

Për rrjedhojë, Komisioni i Ankimit çmon se pretendimet e ngritura nga Komisioni i Vlerësimit përbëjnë elemente që lidhen me procesin e vlerësimit cilësor të aplikimit dhe jo me ekzistencën e shkaqeve të qarta dhe të parashikuara për skualifikimin e organizatës.

Për sa më sipër, Komisioni i Ankimit vlerëson se arsyet e skualifikimit të paraqitura nga Komisioni i Vlerësimit nuk mbështeten në mënyrë të mjaftueshme në kriteret dhe metodologjinë e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara. Nga analiza e dokumentacionit rezulton se një pjesë e konstatimeve lidhen me elemente që përbëjnë avantazh ose ndikojnë në procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të aplikimit, por që nuk janë parashikuar si kriteret skualifikuese.

Në këto kushte, Komisioni i Ankimit çmon se mangësitë e evidentuara nga Komisioni i Vlerësimit, edhe nëse merren të mirëqena, nuk janë të natyrës së tillë që të justifikojnë përjashtimin e organizatës nga procedura e financimit, por përbëjnë elemente që mund të merren në konsideratë vetëm në kuadër të vlerësimit cilësor të aplikimit. Për rrjedhojë, Komisioni i Ankimit vlerëson se skualifikimi i organizatës jofitimprurëse “Qendra Shqiptare për Impakt Social” nuk mbështetet në një bazë të mjaftueshme faktike dhe procedurale dhe, si i tillë, nuk konsiderohet i drejtë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimit, duke marrë në konsideratë ankimin e depozituar nga **“Qendra Shqiptare për Impakt Social”**, mbështetur në rrethanat e faktit, si dhe dokumentacionin e administruar Komisioni i Ankimit konstaton se Vendimi i Komisionit të Vlerësimit Nr. 09, datë 14.05.2026, nuk është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*; Rregulloren *“Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”*, të miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 393, datë 23.11.2020, dhe Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”*, (e ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026).

Në këto rrethana, bazuar në Pikat 16, 17 dhe 18, VKM Nr. 110, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e*

ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Komisioni i Ankimit unanimitisht:

VENDOSI:

1. Pranimin e ankimit të paraqitur nga Organizata Jofitimprurëse **“Qendra Shqiptare për Impakt Social”**.
2. Kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Organizatës jo më vonë se dy ditë nga marrja e vendimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi sipas parashikimeve ligjore.
4. Kundër këtij vendimi ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

KRYETAR

Erjon Ndreca



ANËTAR
Sindi Prifti



ANËTAR
Arsilda Mamica



U shpall në Tiranë,
me datë 01.06.2026.
Ky vendim hartohet në 5 (pesë) kopje.